



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 473 Prot.

Tiranë, më 03.04. 2023

V E N D I M

Nr. _____, datë _____, 2023

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹ bazuar në nenin 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mori në shqyrtim ankesën nr.122 regj, datë 15.08.2022, paraqitur nga Shoqata “Për drejtësi sociale”, në emër të znj. D.M kundër Bashkisë Vlorë, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shoqërore” dhe “etnisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Në ankesën e depozituar pranë Komisionerit, pala ankuese parashtron se, pranë paraligjorit të organizatës Drejtësi Sociale, në qytetin e Fierit, është paraqitur znj. D.M, nga qyteti i Vlorës. Znj. M, është një grua e moshës 60 vjeçare, e cila jeton prej vitesh e vetme. Të ardhurat e saj mujore janë 1800 (njëmijë e tetëqind) lekë nga përfitimi i ndihmës ekonomike. Prej disa vitesh znj. M jeton e detyruar në një dyqan me sipërfaqe 10 m2, në kushte të papërshtatshme banimi, pasi nuk mund të marrë shtëpi banimi me qira, për shkak të pamundësisë financiare për ta përballuar.

Organizata parashtron se, znj. M, është pronare e një trualli 46 m2 dhe një ndërtesë 16 m2, por kjo pronë është zaptuar nga një objekt 3 katësh, i ndërtuar nga znj.T. J. Objekti 3 katësh është

¹ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

vetëdeklaruar për legalizim, por është skualifikuar nga A.SH.K. Vlorë me vendimin nr.14641, datë 28.01.2020. Me vendimin nr.198, datë 12.06.2020, IMT Vlorë ka vendosur prishjen e objektit, por ky vendim nuk është zbatuar nga IMT Vlorë me arsyetimin se nuk ka kapacitete teknike për realizimin e prishjes dhe është e pamundur zgjidhja e kësaj problematike nga ana e tyre. IMT Vlorë i është drejtuar Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit për ekzekutimin e objektit, por pas verifikimit të situatës me anë të shkresës nr.1959/9, datë 22.10.2021, kanë bërë me dije se: *“Për shkak të terrenit të vështirë, ishte e pamundur hyrja e mjetit pasi objekti ndodhej mes disa objekteve të tjera të cilat ishin relativisht shumë afër objektit që duhet të ekzekutohej dhe si pasojë mund të sjellë dëmtime për objektet e tjera që kanë funksion shërbim banese”*.

Në këtë situatë, znj. M nuk mund të shfrytëzojë pronën e saj. E gjendur e vetme dhe e pastrehë ka kërkuar nga Bashkia Vlorë të trajtohet nëpërmjet programeve të strehimit. Bashkia Vlorë ka refuzuar ta trajtojë me programin e subvencionimit të qirasë, me arsyetimin se znj. M zotëron pronë. Znj. M zotëron vërtetë një truall 46 m2 dhe një ndërtesë 16 m2, por nuk i posedon ato dhe është duke banuar në një dyqan në kushte të papërshtatshme për banim. Organizata pretendon se, referuar situatës së znj. D.M dhe përcaktimeve të ligjit nr. 22/2018 *“Për strehimin social”*, nuk ka asnjë pengesë ligjore për trajtimin e saj nga Bashkia Vlorë me programin e strehimit për subvencionimin e qirasë. Sipas palës ankuese, znj. M, ka shkuar disa herë pranë Bashkisë Vlorë, por nuk kanë pranuar t’a trajtojnë me ndonjë nga programet e strehimit dhe sipas saj kjo sjellje e bashkisë është diskriminuese për shkak të gjendjes shoqërore, pasi është një grua e vetme pa asnjë mbështetje, si dhe për shkak të përkatësisë etnike, pasi i përket komunitetit egjiptian.

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri që në përfundim të shqyrtimit të ankesës të konstatojë faktin e diskriminimit nga ana Bashkisë Vlorë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, gërma “b”, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet: *“1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive;”*

Bazuar në dispozitën e mësipërme ligjore rezulton se, kërkesën për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit mund t’a bëjë edhe një palë e cila nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra që nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin. Kjo dispozitë i jep të drjetën Komisionerit për të shqyrtuar, ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm në dy situata të veçanta. Në rastin e parë, organizata me interesa legjitime mund të paraqes ankesë pranë Komisionerit në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi dhe në rastin e dytë, organizata me interesa legjitimë

mund të paraqes ankesë pranë Komisionerit për çështje që lidhen me interesin publik. Në të dy këto raste organizata me interesa legjitimë, nuk pretendon diskriminim në emrin e vet, pra nuk ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë të vetin.

Në rastin e parë kemi të bëjmë me një ankesë individuale pavarësisht se organizata me interesa legjitime, legjitimohet në cilësinë e palës/subjektit që mund të vërë në lëvizje Komisionerin për të filluar një procedurë administrative. Kushti që organizata me interesa legjitime duhet të plotësojë për tu legjitimuar si palë përpara Komisionerit, është fakti se duhet të jetë e pajisur me pëlqimin me shkrim të personit i cili pretendon se është diskriminuar.

Në rastin e dytë kemi të bëjmë me një ankesë të natyrës kolektive, ku interesi legjitim i cënuar, i cili synohet të rivendoset nëpërmjet fillimit të procedurës administrative pranë Komisionerit, nuk është individual por është një interes kolektiv. Në këtë rast që organizata me interesa legjitimë, të legjitimohet për të bërë ankesë dhe për të filluar një procedurë administrative pranë Komisionerit, duhet të provojë se është mbajtëse e interesave kolektive, të cilat mund të cënohen nga procedura konkrete administrative. Një palë e tillë duhet të provojë lidhjen e detyrueshme, të drejtpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë që ajo kryen dhe çështjes së paraqitur pranë Komisionerit.

Bazuar në nenin 3, pika 11, të LMD, përcaktohet se: *“Organizatat me interesa legjitime” janë ato organizata, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë së tyre mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ose u ofrojnë ndihmë viktimave të diskriminimit.”*

Nga aktet e administruara rezulton se, Shoqata “Për drejtësi sociale” është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 6599, datë 14.12.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në statutin dhe aktin e themelimit, konstatohet se Shoqata “Për drejtësi sociale”, është një organizatë jofitimrurëse e krijuar, me qëllimin për të respektuar, promovuar dhe mbrojtur të drejtat dhe liritë themelore, në mënyrë që, pavarësisht dallimeve sociale, ekonomike, racore, ideologjike, krahinore identitetit gjinor, apo çdo aspekti tjetër, të mund të ushtrojnë lirisht të drejtat dhe liritë e tyre themelore dhe të aksesojnë në mënyrë të barabartë shërbimet publike. Në mënyrë të veçantë objekti i veprimtarisë së kësaj organizate konsiston në advokimin, mbrojtjen në mënyrë proaktive dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri.

Bazuar në ankesën e paraqitur Shoqata “Për drejtësi sociale” nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, nuk pretendon cënim të një interesave kolektive, por pretendon diskriminim në emër dhe për llogari të znj. D.M. Në bazë të akteve të administruara rezulton se, znj. D.M, e cila pretendon se është diskriminuar dhe në emër të të cilës, Shoqata “Për drejtësi sociale”, ka paraqitur ankesën objekt shqyrtimi ka dhënë pëlqimin e saj me shkrim për paraqitjen e kësaj ankese.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Shoqata “Për drejtësi sociale”, legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi para Komisionerit, në emër të znj. D.M.

Bazuar në nenin 7, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Ankesa e paraqitur është në përputhje me kërkesat e nenit 33, pika 3, të Ligjit nr.10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar dhe u pranua për shqyrtim, pasi nuk ekziston asnjë nga shkaqet për mospranim të përcaktuara nga neni 33, pika 4, të po këtij ligji. Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të ligjit nr. 10 221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën me nr.1152/1 prot., datë 31.08.2022, Komisioneri ka njoftuar dhe ka kërkuar informacion nga Bashkia Vlorë, në cilësinë e subjektit kundër të cilit është paraqitur ankesa. Me shkresën nr. 9893/1 prot., datë 20.09.2022², Bashkia Vlorë, ka kthyer përgjigje, duke parashtruar si më poshtë:

Bashkia Vlorë, është në dijeni të plotë të situatës së strehimit dhe problematikave të ngritura nga znj. D.M pranë këtij institucioni. Kjo nëpërmjet shkresave të paraqitura nga znj. M, por edhe nga komunikimi i drejtpërdrejtë i realizuar pranë Bashkisë Vlorë me përfaqësues të zyrës së strehimit, pranë kësaj bashkie.

Konkretisht, me pretendimin se është e pastrehë, znj. D.M ka paraqitur një kërkesë me shkrim për të përfituar bonus qiraje të shoqëruar edhe me një kontratë qiraje të lidhur para noterit me një person qiradhënës për një dhomë + tualet, pjesë takuese e një apartamenti që disponon në pronësi pala qiradhënëse. Po kështu, znj. M, ka paraqitur edhe çdo dokumentacion tjetër të përcaktuar nga ligji nr. 22/2018, datë 03.05.2018 *“Për strehimin social”*, pasi subvencioni i qirasë në treg të lirë, ose bonusi i qirasë, jepet për familjet/individët e pastrehë, që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj. Ligji përcakton edhe kategoritë që trajtohen me përparësi. Familjet e komunitetit egjiptian, anëtare e të cilës është znj. M, përshihen në kategoritë që trajtohen me përparësi.

Ka rezultuar se, me vërtetimin e datës 26.10.2020 të nxjerrë nga ASHK Vlorë, znj. M posedon të regjistruar një pasuri të llojit ndërtesë me sipërfaqe 16 m2 dhe truall me sipërfaqe 41.60 m2. Për të

² Protokolluar pranë Komisionerit me nr.1152/2 prot., datë 23.09.2022.

kuptuar dhe sqaruar më mirë pretendimet lidhur me situatën e strehimit të saj, një grup pune me punonjësit e Bashkisë Vlorë dhe të rajoneve përkatëse, në prezencë të znj. M inspektuan banesën që ajo posedon me certifikatë pronësie dhe banesën e marrë me qira. Nga ky verifikim rezultoi se, banesa në pronësi përbëhet nga një dhomë me sipërfaqe 16 m², që përfshihet brenda një ndërtese 3 katëshe, të ndërtuar nga të afërmit e saj dhe 41.60 m² truall.

Mbas vlerësimit të dokumentacionit të plotë rezulton se, për këtë objekt të skualifikuar nga procedurat për legalizimin e objekteve informale të ALUIZNI-t Vlorë, është marrë vendim për prishje nga Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashia Vlorë, por nuk është realizuar prishja në mungesë të kapaciteteve teknike dhe njerëzore.

Nga verifikimi në fakt i objektit, bashkia ka konstatuar mosmarrëveshje dhe situatë të tensionuar midis znj. M dhe të afërmëve të saj, që janë banorë të banesës 3 katëshe, për arsye që rrjedhin nga bashkëpronësia dhe arsye të tjera. Palët u konfliktuan edhe në praninë e përfaqësuesve të bashkisë, duke fajësuar njëra tjetrën për çështje të ndryshme të krijuara nga jetesa e përbashkët në vite, që përbëjnë edhe shkakun e largimit të znj. M nga kjo banesë. Palët kanë qenë në një proces gjyqësor me palë paditëse znj. M, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me objekt “*Lëshim urdhër i menjëhershëm mbrojtje*” dhe palë e paditur T. J. Me vendimin nr.1078, datë 29.10.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka rrëzuar kërkesë padinë që i përket paditëses D.M, duke mos lejuar ankim.

Ndërkaq nga verifikimi i banesës së marrë me qira për të banuar, rezultoi se ajo ishte pjesë e një apartamenti (1+1), ku poseduesja e ka përshtatur për të shërbyer si dyqan, pa kryer procedurat ligjore dhe institucionale të ndryshimit të destinacionit.

Duke shqyrtuar dhe vlerësuar me detaje të gjithë dokumentacionin, kushtet dhe faktorët realë të zhvendosjes nga banesa e pajisur me dokumenta pronësie dhe banesa ku realisht jeton znj. M, Bashkia Vlorë konkludoi se, pavarësisht rrethanave dhe problematikave, kërkesa për të përfituar subvencionin e qirasë bie në kundërshtim me ligjin nr.22/2018, datë 03.05.2018 “*Për strehimin social*”, neni 13 dhe 34.

Bashkia Vlorë informon se, në 5 vitet e fundit, programet e strehimit social, të zbatuara nga ana e saj, në zbatim të ligjit nr.22/2018 “*Për strehimin soacial*” kanë qenë si vijon:

- Programi i përmirësimit të kushteve fizike të banesave për komunitetet e varfëra dhe shtresa të pafavorizuara.
 1. Viti 2017, 67 familje aplikante, 20 familje përfituese, anëtare të minoritetit egjiptian, kjo është përcaktuar nga ministria që financon projektin.
 2. Viti 2018, nuk u paraqitën aplikime.
 3. Viti 2019, 41 aplikime, 34 familje përfituese, anëtare të minoritetit egjiptian.
 4. Viti 2020, 60 aplikime, 29 përfitues të minoritetit rom.
 5. Viti 2021, 7 aplikime, 6 familje përfituese anëtare të minoritetit egjiptian.
 6. Viti 2022, 4 aplikime, 2 familje përfituese anëtarë të minoritetit egjiptian.

- Në zbatim të programit të banesave sociale me qira, Bashkia Vlorë ka zbatuar instrumentin e bonusit të qirasë ose subvencionit i qirasë në tregun e lirë, si vijon:
 1. Viti 2017, 30 aplikime në total, 18 përfitues nga minoriteti egjiptian.
 2. Viti 2018, 28 aplikime në total, 12 përfitues nga minoriteti egjiptian.
 3. Viti 2019, 27 aplikime në total, 14 përfitues nga minoriteti egjiptian.
 4. Viti 2020, 24 aplikime në total, 17 përfitues nga minoriteti egjiptian.
 5. Viti 2021, 40 aplikime në total, 11 përfitues nga minoriteti egjiptian.
 6. Viti 2022, 33 aplikime në total, 11 përfitues nga minoriteti egjiptian.
- Programi i banesave me kosto të ulët, nëpërmjet subvencionimit të interesave të kredive nga buxheti i shtetit dhe buxheti i bashkisë.

Sipas njoftimeve të shpallura nga bashkia me çdo mjet të mundshëm informimi, janë kryer procedurat e aplikimeve, të shqyrtimit në komisionet përkatëse të bashkisë dhe Këshillit të Bashkisë, miratimi i familjeve përfituese nga Këshilli i Bashkisë, sipas plotësimit të kushteve të projektit dhe finalizimi i procedurave në bankë.

2. Me e-mail, datë 26.09.2022, Shoqata “Për drejtësi sociale”, ka paraqitur prapësimet e saj, në lidhje me qëndrimin e mbajtur nga ana e Bashkisë Vloë, duke parashtruar si vijon:

Së pari, nuk kemi të bëjmë me pretendim të znj. M se është e pastrehë, por ajo është e pastrehë, kjo referuar dhe verifikimit të kryer nga ana e punonjësve të Bashkisë Vlorë.

Së dyti, referuar shkresës së ASHK-së që tregon se znj. M ka në pronësi të saj 16 m² ndërtesë dhe 41.60 m² truall, iu sjellim në vëmendje që prej disa vitesh nuk posedohen, pasi janë zënë nga një ndërtesë e paligjshme dhe nuk ka asnjë shans që dhe në të ardhmen të posedohen nga ajo, pasi çuditërisht institucionet lokale dhe qendrore kanë mungesë kapacitetesh teknike dhe njerëzore për të prishur një ndërtesë, ndërkohë që çdo ditë shohim të prishen ndërtesa në çdo qytet të shqipërisë.

Së treti, është e palogjikshme akuza që ngrihet nga bashkia përse i përket ndryshimit të destinacionit të dhomës së marrë me qera nga ana e zonjës, pasi si mund të ndryshoi ajo destinacionin kur nuk është pronare e saj. Znj. M duke pasur vështirësi për të gjetur një banesë dhe pamundësisë financiare për ta paguar, ka gjetur si mundësi të vetme strehimin e saj në një dhomë (dyqan) 12 m² në kushte të papërshtatshme strehimi.

Së katërti, referuar nenit 13, të ligjit "Për strehimin social" përcaktohet se: "statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme: a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Edhe nëse znj. M do ta posedonte pronën e saj (ndërtesë) 16 m², sërish nuk do të zotëronte sipërfaqe sipas normës së strehimit për një person, që është 30 m². Kjo do të thotë se znj. M mund të përfitojë nga programet e ligjit "*Për strehimin social*". Ndërkohë, ashtu siç provohet dhe nga vet bashkia, znj. M *de facto* nuk posedon asnjë banesë dhe jeton në një banesë jashtë standardeve në fuqi.

3. Bazuar në nenin 33/8, të ligjit nr.10221/2010 "*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*", të ndryshuar ku parashikohet: "*Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.*" dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, me shkresën nr. 1152/3 prot., datë 13.10.2022, njoftoi palët për zhvillimin e një seance dëgjimore publike.

Seanca dëgjimore u zhvillua në datën 01.11.2022, me pjesëmarrjen vetëm të palës ankuese Shoqatës "*Për drejtësi sociale*" përfaqësuar nga Kryetari i Shoqatës, z. Gentian Sejrani. Në seancë dëgjimore nuk u paraqit Bashkia Vlorë, e cila kishte rregullisht dijeni për datën dhe orën e seancës dëgjimore publike, njoftuar me shkresën nr.1152/3 prot., datë 13.10.2022.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i palës ankuese deklaroi se, statistikat e paraqitura nga ana e Bashkisë Vlorë që kanë të bëjnë me familjet egjiptiane të cilat trajtohen me bonus qiraje, nuk kanë të bëjnë me situatën e ankueses, pasi këto familje kanë përfituar për shkak të prekjës së pronës së tyre nga investimet publike. Përfaqësuesi i palës ankuese theksoi gjithashtu se, pretendimet për diskriminim ndaj znj. M bazohen edhe në mënyrën e komunikimit dhe trajtimit të rastit, nga ana e Bashkisë Vlorë, konstatime këto të bëra edhe nga ana e shërbimit të ndihmës juridike falas në Vlorë, të cilët kanë ndjekur problematikën e saj.

4. Në vijim të seancës dëgjimore, me shkresat nr.1152/5 prot., datë 21.11.2022 dhe nr.1152/8 prot., datë 19.12.2022, Komisioneri kërkoi informacion shtesë nga ana e Bashkisë Vlorë në lidhje me, shkakun ligjor mbi bazën e të cilit familjet e minoritetit egjiptian kanë përfituar nga instrumenti i bonusit të qirasë ose subvencionit i qirasë në tregun e lirë, dhe se sa prej përfituesve nga minoriteti egjiptian që kanë përfituar, kanë qenë në kushte të ngjashme me znj. D.M, pra gra të vetme. Me anë të kësaj shkresë Bashkia Vlorë iu kërkuan për shqyrtim kopje të praktikash të ngjashme, kur aplikimet për të përfituar nga instrumenti i bonusit të qirasë, ishin refuzuar për të njëjtat arsye sikurse për rastin e znj. M.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, Bashkisë Vlorë me shkresën nr.13277/1 prot., datë 15.12.2022³, ndër të tjera parashittoi se, znj. D.M nuk është përfituese e subvencionit të qirasë për arsye se kërkesa e saj bie në kundërshtim me nenet 13 dhe 34, të ligjit nr.22/2018, datë 03.05.2018 "*Për strehimin social*" dhe jo për faktin e pretenduar prej saj, për shkak të gjendjes shoqërore dhe përkatësisë etnike. Përgjithësisht familjet e komunitetit egjiptian ndër vite, përbëjnë rreth 30-40 % të të gjithë përfituesve të bonusit të qirasë në Bashkinë Vlorë.

³ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 1152/7 prot datë 19.12.2022.

5. Me shkresën nr. 1152/5 prot., datë 21.11.2022, Komisioneri iu drejtua Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas, duke kërkuar informacion në lidhje trajtimin e rastit të znj. M nga ana e shërbimit të ndihmës juridike si dhe konstatimet e tyre në lidhje me qasjen e Bashkisë Vlorë për trajtimin e rastit dhe problematikës së znj. D.M. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 2114/1 prot., datë 01.12.2022, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, informoi Komisionerin duke parashtruar sa më poshtë vijon:

Znj. D.M është paraqitur për herë të parë në datën 18.06.2021, pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, ku ka parashtruar problematikën në lidhje me ekzekutimin e vendimit nr. 198, datë 12.06.2020 *“Për prishjen e objektit të paligjshëm”*. Nga ana e punonjësve është ofruar informacion dhe këshillim ligjor si dhe është ofruar asistencë për hartimin e një kërkesë për ekzekutimin e vendimit për prishjen e objektit të paligjshëm, drejtuar Drejtorisë Rajonale të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Në mungesë të një përgjigje nga ana e IKMT Vlorë, më datë 30.07.2021, znj. M është asistuar për hartimin e një shkrese drejtuar IKMT Tiranë. Znj. M është paraqitur përsëri pranë Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë më datë 14.07.2021, duke informuar punonjësit se vijon të mos ketë marrë asnjë përgjigje referuar kërkesave të bëra.

Në kushtet kur znj. M është pjesë e komunitetit egjiptian, Qendra e Shërbimit të Ndhmës të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë kërkoji bashkëpunimin e organizatës *“Për Drejtësi Sociale”*, një organizatë e dedikuar në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të kategorive romë dhe egjiptiane, me të cilën Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshjen me nr.13/1 prot., datë 07.01.2021. Punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, së bashku me përfaqësuesit e organizatës *“Për Drejtësi Sociale”*, më datë 19.07.2022 kanë vizituar objektin (ndërtesën) ku znj. M ka deklaruar se banon dhe kanë konstatuar kushte të papërshtatshme banimi.

Në përfundim të takimit, punonjësit e Qendrës së Shërbimit të ndihmës Juridike Parësore Vlorë dhe përfaqësuesit e organizatës *“Për Drejtësi Sociale”*, nisur nga pretendimet e znj. M dhe mosveprimin e organeve kompetente, ranë dakord që këtë rast ta përcillnin për trajtim pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjithashtu, referuar situatës nga punonjësit e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë është hartuar shkresa nr. 43 prot., datë 25.07.2022 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.09.2022, drejtuar Bashkisë Vlorë, nëpërmjet të cilave kërkohet informacion mbi rastin e shtetas D.M. Në datën 21.09.2022, nga ana e Bashkisë Vlorë është kthyer përgjigje me shkresën nr.8340/1 prot, protokolluar pranë Qendrës me nr.43/2 prot., nëpërmjet të cilës shprehet se kërkesa për subvencionin e qirasë bie në kundërshtim me nenet 13 dhe 14 të ligjit nr.22/201, datë 03.05.2018 *“Për strehimin social”*.

Në vlerësimin në tërësi të situatës, punonjëset e Qendrës së Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore Vlorë, kanë konstatuar vonesa në kthimin e përgjigjes dhe ndërmarrjen e masave nga ana e institucioneve kompetente pavarësisht kushteve ekonomike dhe kategorisë vulnerabël në të cilën znj. M bën pjesë.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Gjatë procedurës administrative të shqyrtimit të ankesës rezultoi e provuar se, ankuesja D.M, e datëlindjes 08.07.1962, është banore e Bashkisë Vlorë. Znj. M, është me gjendje civile beqare dhe është kryefamiljare e vetme, fakte këto që rezultojnë të provuara në bazë të certifikatës familjare të lëshuar në datën 05.11.2020, nga Zyra e Gjendjes Civile 415, Njësia Administrative Vlorë 415, Bashkia Vlorë.

Sipas dokumentacionit të lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Rajonale Vlorë, ankuesja rezulton pronare e një pasurie të paluajshme e llojit truall me sipërfaqe 41.60 m2 dhe e një ndërtese me sipërfaqe 16 m2. Banesa në pronësi të ankueses përbëhet nga 1 dhomë me sipërfaqe 16 m2, që përfshihet brenda një ndërtese 3 katëshe të ndërtuar nga persona të tretë. Ndërtesa 3 katëshe, është vetëdeklaruar për legalizim nga znj. T. J., por është skualifikuar nga procedurat e legalizimit nga ALUIZNI Vlorë. Në vijim, me vendimin nr. 198, datë 12.06.2020, Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Vlorë (IMT Vlorë) ka marrë vendim për prishjen e këtij objekti të kundraligjshëm.

Vendimi për prishjen e objektit 3 katësh të ndërtuar në mënyrë të paligjshme, nuk është ekzekutuar nga ana e IMT Vlorë me arsyetimin se nuk ka kapacitetet teknike për realizimin e prishjes, referuar shkresës nr. 8772 prot., datë 02.06.2021, e IMT Vlorë. Sipas shkresës nr.1959/9 prot., datë 22.10.2021, të Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), rezulton se IMT Vlorë ka kërkuar bashkëpunim nga ana e IKMT për realizimin e prishjes së objektit. Nga verifikimet e kryra nga ana e IKMT, ka rezultuar se për shkak të terrenit të vështirë, ishte e pamundur hyrja e mjetit pasi objekti ndodhej mes disa objekteve të tjera të cilat ishin relativisht shumë afër objektit që duhet të ekzekutohej dhe si pasojë mund të sillte dëmtime për objektet e tjera që kanë funksion shërbim banese.

Sikurëse shprehet në shkresën nr. 9893/1 prot., datë 20.09.2022, nga verifikimi në fakt i objektit, Bashkia Vlorë ka konstatuar mosmarrëveshje dhe situatë të tensionuar midis ankueses dhe banorëve të banesës 3 katëshe.

Në këto kushte, duke mos patur mundësi që të shfrytëzojë pronën e saj, ankuesja ka marrë me qira një ambient për banim të përbërë nga një dhomë dhe një tualet, ambient i cili është pjesë e një apartamenti me strukturë 1+1. Për këtë qëllim ankuesja ka nënshkruar para noterit kontratën e qirasë me nr.1640 rep. dhe nr.765 kol. datë 09.11.2020, para noteres Juljana I.Bino.

Në datën 10.11.2020, ankuesja D.M, ka aplikuar pranë Bashkisë Vlorë, për të përfituar nga programet e strehimit social, konkretisht atë të bonusit të qirasë, duke depozituar kopjen e kontratës së qirasë, vërtetimin për pronën që dispononte, vërtetimin që nuk kishte aplikuar për legalizim, kopje të dokumentit të identifikimit dhe certifikatën familjare. Ankuesja nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare në lidhje me këtë aplikim.

Në datën 27.01.2021, ankuesja i është drejtuar sërish Bashkisë Vlorë me kërkesën për të përfituar bonus qiraje ose për t'i siguruar asaj një strehim të përshtatshëm, kërkesë e cila është administruar pranë Bashkisë Vlorë me nr.982 prot datë 27.01.2021. Edhe për këtë kërkesë, ankuesja nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare.

Në datën 08.03.2021, ankuesja ka depozituar një kërkesë të tretë pranë Bashkisë Vlorë, duke parashtruar edhe njëherë nevojën për t'i siguruar një strehim të përshtatshëm nëpërmjet trajtimit me bonus qiraje, e cila është administruar pranë Bashkisë Vlorë me nr. 4162 prot., datë 06.04.2021. Në përgjigje të kësaj kërkesë, Bashkia Vlorë i ka kthyer përgjigje ankueses me anë të shkresës nr. 4162/1 prot., datë 06.04.2021, në të cilën parashtron: *“Ashtu si ju kemi informuar edhe në komunikimin e drejtpërdrejtë të zhvilluar në Bashkinë Vlorë, në drejtorinë përgjegjëse për strehimin, subvencionin e qirasë në treg të lirë ose bonusin e qirasë, jepet për familjet/individët e pastrehë, që plotësojnë kushtet dhe kriteret e përcaktuara me ligj. Ligji përcakton edhe kategoritë që trajtohen me përparësi. Në rastin tuaj rezulton se, me vërtetimin datë 16.10.2020 të nxjerrë nga ASHK Vlorë, ju posedoni të regjistruar një pasuri të llojit ndërtesë me sipërfaqe 16 m2 dhe truall me sipërfaqe 41.60 m2. Me këtë pasuri në pronësi, brenda normave të strehimit të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi për strehimin, vërtetohet se ju nuk jeni person i pastrehë. Pra, kërkesa juaj për të përfituar bonus qiraje, pavarësisht se keni paraqitur një kontratë qiraje të nënshkruar para noterit me një person qiradhënës, bie në kundërshtim me përcaktimet në ligjin për strehimin, ku shkruhet se, çdo përdorim i bonusit të strehimit për qëllime të tjera përveç asaj për të cilën është miratuar përbën shkelje”.*

Rezulton se, znj. D.M, ka kërkuar ndihmë juridike parësore falas, për trajtimin e problematikës së saj pranë Qendrës së Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Vlorë (QSHNJP Vlorë). Referuar shkresës nr. 2114/1 prot., datë 01.12.2022 të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, rezulton se, në datën 19.07.2022, QSHNJP Vlorë së bashku me organizatën “Për Drejtësi Sociale”, kanë vizituar objektin (ndërtesën) ku ankuesja banon aktualisht. Gjatë kësaj vizite ata kanë konstatuar se, znj. M, jetonte në kushte të papërshtatshme banimi. Foto të realizuara gjatë kësaj vizite janë vendosur në dispozicion të Komisionerit nëpërmjet shkresës nr.2114/1 prot., datë 01.12.2022.

Me shkresën nr.43 prot., datë 25.07.2022 dhe nr. 43/1 prot., datë 14.09.2022, QSHNJP Vlorë, ka kërkuar informacion nga ana e Bashkisë Vlorë lidhur me problematikën e strehimit të paraqitur në mënyrë të përsëritur nga znj. M. Në korrespondencën e mbajtur me Bashkinë Vlorë, QSHNJP Vlorë kërkon që bashkia ta trajtojë znj. M me një nga programet sociale të strehimit, pasi ajo ka mbetur e pastrehe si pasojë e pamundësisë nga ana e institucioneve kompetente për të zbatuar

aktin administrativ për prishjen e objektit 3 katësh të ndërtuar në mënyrë të paligjshme i cili ka zaptuar pronën e saj.

Me shkresën nr.8340/1 prot. – nr.10328/1 prot. (shkresa ka dy numra protokolli), datë 21.09.2022, Bashkia Vlorë i ka kthyer përgjigje QSHNJP Vlorë, duke e informuar se, pavarësisht rrethanave dhe problematikave, kërkesa e znj. M, për të përfituar subvencionin e qirasë, bie në kundërshtim me nenet 13 dhe 324, të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social”.

Sipas palës ankuese, nuk ka asnjë pengesë ligjore sipas përcaktimeve të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” për trajtimin e z. D.M me programin e strehimit social, atë të subvencionit apo bonusit të qirasë, nga ana e Bashkisë Vlorë.

Në këto kushte, pala ankuese, ka paraqitur ankesën nr. 122 datë 15.08.2022 kundër Bashkisë Vlorë, duke pretenduar se, sjellja dhe refuzimi i Bashkisë Vlorë, për t’a trajtuar atë me rimbursimin e qirasë, ka ndodhur për shkak të gjendjes së saj shoqërore, pasi ajo është grua e vetme pa asnjë mbështetje dhe për shkak të përkatësisë etnike, pasi i përket minoritetit egjiptian dhe jo për shkak të mospërmbushjes së kriterëve ligjore të parashikuara nga ligji nr.22/2018 “Për strehimin social”, sikurse pretendon Bashkia Vlorë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, Bashkia Vlorë deklaroi së arsyeja e refuzimit të kërkesës së znj. D.M për të përfituar nga programi social i subvencionimit të qirasë, është mospërmbushja nga ana e saj e kriterëve ligjore të parashikuara nga neni 13 dhe 34 të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” dhe jo shkaqet diskriminuese të pretenduara nga pala ankuese. Sipas Bashkisë Vlorë, znj. M nuk i plotëson kriteret ligjore të përcaktuara nga dispozitat e mësipërme ligjore, sepse ajo nuk është e pastrehë, pasi ka në pronësi një pasuri të llojit ndërtesë me sipërfaqe 16 m2 dhe truall me sipërfaqe 41.60 m2.

Sipas nenit 34, të ligjit nr.22/2018, subvencionin e qirasë, është një instrument i programit të banesave sociale me qira, që ndihmon individët/familjet, të cilët me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale. Referuar nenit 11, të ligjit nr.22/2018, programi i banesave sociale me qira, është një nga llojet e programeve të strehimit social.

Kushtet për fitimin e statusit të përfituesit nga programet sociale të strehimit, përcaktohen në nenin 13, të ligjit nr.22/2018. Në pikën 1, të nenit 13, të ligjit nr.22/2018, parashikohet:

“1. Statusin e përfituesit nga programet sociale, sipas këtij ligji, e gëzon çdo individ që ka mbushur moshën 18 vjeç dhe familjet e regjistruara në zyrat e gjendjes civile në njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilët në momentin e aplikimit plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) nuk kanë në pronësi një banesë ose zotërojnë sipërfaqe banimi nën normat e strehimit apo banojnë në banesa jashtë standardeve në fuqi, për të cilat normat e strehimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave;

b) kanë mbetur të pastrehë, si rezultat:

i) i fatkeqësive natyrore;

ii) i prishjes së objekteve të pakualifikuara si banesë;

iii) i zhvendosjeve për shkak të investimeve publike dhe nga objektet e përjashtuara nga procesi i legalizimeve;

iv) nga zbatimi i akteve administrative dhe zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë;

c) familjet që kanë një banesë të vjetër, në rrezik shembjeje, ose një banesë që i nënshtrohet një plani rregullues, për shkak të vjetërsisë së saj.”

Referuar nenit 13, pika 1, germa “a” të ligjit nr.22/2018, rezulton se një nga kriteret që skualifikon një individ nga e drejta për të përfituar nga programet e strehimit social është pasja në pronësi e një banese.

Nga aktet e administruara, rezulton e provuar se znj. M ka të regjistruar në emrin e saj dhe është e pajisur me certifikatë pronësie, një pasuri të paluajtshme të llojit ndërtesë me sipërfaqe 16 m2, banesë e cila sipas verifikimeve të kryera nga ana e Bashkisë Vlorë përfaqësohet nga një dhomë, pa ambiente të tjera.

Përkufizimi i së drejtës së pronësisë në legjislacionin shqiptar e gjejmë në nenin 149 të K.Civil në të cilin parashikohet: “Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar me ligj”. Në themel të së drejtës të pronësisë qëndrojnë e drejta për të gëzuar pronën, e drejta për ta disponuar atë si dhe e drejta për ta poseduar. Ndërsa pronësia përfaqëson një situatë juridike mbi sendin, posedimi përfaqëson situatën reale dhe faktike të subjektit mbi pronën. Posedimi është në fakt sundimi dhe pushteti efektiv, faktik mbi sendin. Ligjërisht znj. M duhet të gëzojë lirisht dhe posedojë pronën e saj, pra të jetë poseduese faktike mbi banesën me sipërfaqe 16 m2 dhe truallin prej 41.06 m2. Nga faktet e konstatuara gjatë shqyrtimit të ankesës, rezultoi e provuar se, znj. D.M është pronare e banesës vetëm de jure, pasi ajo de facto nuk e sundon efektivisht dhe faktikisht banesën. Znj. M rezulton pronare e banesës prej 16 m2 vetëm në dokumentacionin shkresor. Sikurse rezulton, banesa e saj është zaptuar nga një objekt 3 katësh i cili është ndërtuar në mënyrë të paligjshme, i konstatuar si i tillë nga autoritetet kompetente dhe këta të fundit nuk kanë bërë të mundur ekzekutimin e vendimit për prishjen e këtij objekti dhe për të mundësuar rrjedhimisht që ankuesja të mund të gëzojë lirisht pronën e saj. Përpos këtij fakti, nga verifikimet e kryera nga ana e Bashkisë Vlorë, kjo e fundit ka konstatuar se marrëdhëniet midis znj. M, dhe personave të cilët kanë ndërtuar në mënyrë të paligjshme objektin 3 katësh, janë të tensionuara dhe kanë shërbyer si faktor për largimin e znj. M nga banesa që ajo disponon me certifikatë pronësie.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se, znj. Dallandshe M, nuk e gëzon *de facto* të drejtën e pronësisë mbi banesën prej 16 m2, por vetëm *de jure*. Në këto kushte, kur Bashkia Vlorë ka dijani të plotë mbi këtë fakt, pra, që znj. D.M *de facto* nuk e gëzon të drejtën e pronësisë për të

gjitha arsyet e cituara më sipër, ka arritur në mënyrë të gabuar në përfundimin që ajo ka në pronësi një banesë, dhe për këtë fakt ka refuzuar në kundërshtim me ligjin nr.22/2018, kërkesën për t'a trajtuar me instrumentin e subvencionimit të qirasë.

Megjithatë, edhe nëse do të pranohet faktin që rrethanat e mësipërme nuk do të përligjin cënimin e të drejtës së pronësisë së znj. M mbi banesën prej 16 m² që ajo zotëron me dokumentacion, rezulton se edhe në këtë situatë, ajo zotëron sipërfaqe banimi nën normat e strehimit të miratuara nga Këshilli i Ministrave.

Normat e strehimit, janë përcaktuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 301, datë 15.4.2020 "Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët. Në pikën 1 dhe 3 të kësaj VKM-je përcaktohet :

"1. Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë:

a) normën e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit,

b) kushtet dhe standardet për banesat sociale me qira që blihen në treg;

c) standardet e banesave me kosto të ulët.

.....

3. Norma e strehimit për programet e strehimit social, në përputhje me parimet e politikave të strehimit, bazuar në nenet 3 deri 10, të ligjit nr.22/2018, "Për strehimin social", është 30 m² sipërfaqe neto për personin e parë. Për çdo person shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10m² dhe llogaritet sipas formulës më poshtë:

Sipërfaqja Neto e Banesës = 20m² + N x 10 m²

Ku:

Sipërfaqja neto e banesës: është sipërfaqja e shfrytëzimit pa muret e brendshme dhe perimetrale, e quajtur ndryshe si sipërfaqja e përdorshme ose e shkeljes.

N është numri i banorëve mbi moshën 5 (pesë) vjeç".

Referuar normës së strehimit të përcaktuar nga pika 3 e VKM nr.301/15.04.2020, rezulton se, sipërfaqja e mjaftueshme për të garantuar një strehim të përshtatshëm për një individë është 30 m².

Në të nenit 4 "Parimi i strehimit të përshtatshëm", të ligjit nr.22/2018, përcaktohet :

" 1. Strehimi konsiderohet i përshtatshëm për një individ dhe/ose familje atëherë kur garanton privatësinë, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet.

2. Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson:

a) hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;"

Referuar fakteve dhe rrethanave në të cilat ndodhet znj. M, rezulton se ajo ka aplikuar për herë të parë në datën 10.11.2020, për të përfituar në një nga programet e strehimit social, konkretisht për të përfituar nga instrumenti i subvencionimit të qirasë. Në bazë të certifikatës familjare, znj. M jeton e vetme dhe në bazë të dokumentacionit rezulton se banesa që ajo ka të regjistruar në emrin e saj është 16 m2. Normat e strehimit të parashikuara nga VKM nr. 301/15.04.2020, i cili është akti që ka qenë në fuqi në kohën që znj. M ka paraqitur aplikimin e saj për të përfituar bonusin e qirasë, është 30 m2 sipërfaqe neto për personin e parë.

Sa më sipër, rezulton se edhe nëse marrim të mirëqenë se znj. M gëzon në mënyrë efektive pronësinë e banesës prej 16 m2, përsëri ajo është në një situatë kur zotëron sipërfaqe banimi nën normat e strehimit që mundësojnë një strehim të përshtatshëm. Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, edhe në këtë rast Bashkia Vlorë ka arritur në një përfundim të padrejtë dhe të gabuar se znj. M ka në pronësi një banesë brenda normave të strehimit të përcaktuara nga aktet ligjore në fuqi dhe duke refuzuar kërkesën për subvencionim të qirasë.

Si pasojë e refuzimit të kërkesës për tu trajtuar me subvencionimin e qirasë nga ana e Bashkisë Vlore, rezultoi se znj. M është detyruar të jetojë në një ambient jo të përshtatshëm për banim, fakt ky që rezulton i provuar në bazë të verifikimit të kryer nga Ndhma Juridike Falas, pranë Bashkisë Vlorë dhe fotot e realizuara prej tyre dhe të vendosura në dispozicion të Komisionerit. Nga verifikimi i pamjeve fotografike të vendosura në dispozicion nga Ndhma Juridike Falas, Komisioneri ndan të njëjtin qendrim me këtë të fundit në lidhje me kushtet e papërshtatshme të banimit në ambientet ku është detyruar të jetojë znj. M, si pasojë e refuzimit të kërkesës së saj për tu trajtuar me subvencionimin e qirasë, në kuadër të programeve të strehimit social nga ana e Bashkisë Vlorë. Kushtet e papërshtatshme të banesës në të cilën znj. M jeton, nuk u kundërshtuan nga Bashkia Vlorë, e cila gjatë shqyrtimit të ankesës pranon rrethanat dhe problematikat në lidhje me rastin e znj. D.M, pavarësisht se, në mënyrë të pabazuar në ligj ka refuzuar kërkesën e saj për tu trajtuar me subvencionin e qirasë.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, refuzimi i kërkesës së znj. D.M, për të përfituar nga subvencionimi i qirasë, e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke iu mohuar e drejta për të përfituar strehim të përshtatshëm nga programet sociale të strehimit, nga ana e Bashkisë Vlorë.

B. Shkaku i mbrojtur

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtsisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë mbrojtjen nga disriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ligji Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë shkaqet e diskriminimit të pretenduar nga pala ankuese, “etnia” dhe “gjendja shoqërore”, sipas përmbajtjes në vijim: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, **etninë**, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, **gjendjen** ekonomike, arsimore ose **shoqërore**, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se znj. D.M është diskriminuar për më shumë se një shkak dhe konkretisht, për shkak të “etnisë” dhe “gjendjes shoqërore”.

Në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij. E njëjta qasja gjen zbatim edhe kur pretendohet se diskriminimi ka ndodhur për më shumë se një shkak.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të etnisë, Komisioneri vlerëson se “etnia” parashikohet shprehimisht si një shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD.

“Përkatësia etnike” ose e thënë ndryshe “etnia”, sipas Fjalorit të Gjuhës së Sotme Shqipe përkufizohet si “bashkësi e qëndrueshme njerëzish, e formuar historikisht në një truall të caktuar e cila ka një gjuhë dhe kulturë materiale e shpirtërore të njëjtë” (shih vendimin nr. 52 datë 01.12.2011, të Gjykatës Kushtetuese)

Ndërsa termi “etni” nuk ka një përkufizim ligjor, në nenin 3, pika 1 të ligjit Nr. 96/2017 “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” jepet përkufizimi për termin “pakicë kombëtare”, sipas formulimit vijues: “1. Pakicë kombëtare është një grup shtetasish shqiptarë që banojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, kanë lidhje të hershme dhe të qëndrueshme me

shitetin shqiptar, shfaqin karakteristika dalluese kulturore, etnike, gjuhësore, fetare ose tradicionale dhe të cilët janë të gatshëm për të shprehur, ruajtur dhe zhvilluar së bashku identitetin e tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional. “ Në pikën 2, të dispozitës së mësipërme ligjore parashikohet: 2. Në kuptimin e këtij ligji, pakicat kombëtare në Republikën e Shqipërisë janë pakicat greke, maqedonase, arumune, rome, egjiptiane, malazeze, boshnjake, serbe dhe bullgare.”

Etnia dhe **raca** janë koncepte të ndërlidhura dhe të mbivendosura. Ndërsa nocioni i racës i ka rrënjët në idenë e klasifikimit biologjik të qenieve njerëzore në nën-specie në bazë të veçorive morfologjike si ngjyra e lëkurës ose karakteristikat e fytyrës, përkatësia etnike e ka origjinën në idenë e grupeve shoqërore të shënuara në veçanti nga kombësi e përbashkët, përkatësi fisnore, besimi fetar, gjuhë e përbashkët, origjinën dhe prejardhjen kulturore ose traditat e përbashkëta. Diskriminimi për shkak të origjinës aktuale ose të perceptuar etnike të një personi është një formë e diskriminimit racor⁴.

Ndërsa përkatësia etnike apo në një pakicë kombëtare bazohet në të drejtën për tu vetidentifikuar si dhe në të drejtën e personit për të zgjedhur lirisht që të trajtohet ose jo si i tillë, në lidhje me provueshmërinë e shkakut të “etnisë” pala ankuese depozitoi edhe vërtetimin e datës 22.08.2022, të lëshuar nga ana e Shoqatës “Për drejtësi sociale”, sipas të cilit vërtetohet se znj. D.M, është anëtare që i përket minoritetit Egjiptian të Shqipërisë.

Sa më sipër, Komisioneri konsideron plotësisht të provuar shkakun e pretenduar të diskriminimit, atë të “etnisë”.

Në lidhje me pretendimin për diskriminim për shkak të gjendjes shoqërore, ankuesja pretendon se i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe i është mohuar barazia për këtë shkak pasi është grua e vetme pa asnjë mbështetje.

Komisioneri vlerëson se “*gjendja shoqërore*” parashikohet shprehimisht si një shkak i mbrojtur nga neni 1, i LMD, megjithatë mungon një praktikë e konsoliduar juridike në nivelin kombëtar ose ndërkombëtar, e cila do të ndihmonte për të kuptuar qartë se çfarë elementësh përfshihen në gjendjes shoqërore, për t’u konsideruar si shkak i mbrojtur në kuptim të ligjit.

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara, i cili është organi përgjegjës për monitorimin dhe interpretimin e Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, interpreton në Komentin e Përgjithshëm nr.20 “*Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*”, se gjendja ekonomike dhe sociale e individit përbën një shkak të ndaluar diskriminues duke sqaruar se: “*Individët dhe grupet e individëve nuk duhet të trajtohen në mënyrë arbitrare për shkak se i përkasin një grupi apo shtrese të caktuar ekonomike apo sociale brenda shoqërisë. Gjendja sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë, mund të rezultojë në diskriminim të përhapur,*

⁴ Shiko: Sejdić dhe Finci kundër Bosnjës dhe Hercegovinës [GC], 2009; Timishev kundër Rusisë, 2005

stigmatizim dhe stereotipe negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike”.

Në Kanada, Karta e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut të Kebekut (Québec Charter of Human Rights and Freedoms) përfshin “*gjendjen sociale*” (social condition) si një nga shkaqet e ndaluara të diskriminimit. Komisioni i të Drejtave të Njeriut në Kebekut, (Québec Commission des droits de la personne et des droits de la jeunesse) e ka përcaktuar këtë ndalim se “*i referohet një shkalle, një pozicioni shoqëror ose një klase që i atribuohet dikujt, kryesisht në bazë të nivelit të të ardhurave, punësimit dhe nivelit arsimimit të tyre*”⁵.

Komisioneri vlerëson se, *gjendja shoqërore*, si shkak i ndaluar diskriminimi është një koncept i gjerë. *Shkaku i gjendjes shoqërore*, i referohet situatës aktuale të një personi në shoqëri ose të prezumimit të përkatësisë në një pozicion të caktuar shoqëror, në të cilën personi gjendet si pasojë e nivelit të të ardhurave, aspekteve që kanë të bëjnë me përkatësinë në një profesion të caktuar dhe punësimin, përfshi këtu edhe situatën e papunësisë, si dhe aspekte që kanë të bëjnë me nivelin arsimor të personit. Ky shkak mbron kryesisht personat që janë të pafavorizuar për shkak të pozitës së tyre shoqërore. Kriteret e mësipërme, për të vlerësuar gjendjen shoqërore të një personi, nuk janë shteruese apo kumulative, dhe se do të mjaftonte vetëm ekzistenca e vetëm njërit prej disavantazheve të mësipërme, në mënyrë që të provohet shkak i gjendjes shoqërore.

Komisioneri konstaton se, shkak i gjendjes shoqërore, i pretenduar si shkak diskriminimi nga pala ankuese, ka në bazë të tij gjininë e znj. D.M, pra faktin që ajo është grua, ndërsa këtij statusi i shtohet gjendja se znj. D.M, si një grua e vetme. Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se ankesa objekt shqyrtimi duhet të vlerësohet edhe në kuadër të diskriminimit për shkak të “*gjinisë*”, shkak ky i cili parashikohet shprehimisht si një shkak i mrojtur nga neni 1, i LMD.

Znj. D.M, është një grua beqare, kryefamiljare e vetme, e cila ka si mjet të vetëm për të siguruar jetesën ndihmën ekonomike.

Në këtë kontekst, Komisioneri kryesisht çmon se çështja duhet të shqyrtohet edhe në kuadër të gjendjes ekonomike të znj. D.M, si një shkak i ndaluar diskriminimi, i cili parashikohet në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 1, i LMD.

Shkaku i gjendjes ekonomike, i referohet kryesisht situatës aktuale të një personi për sa i përket pasurisë, pronës, apo karakteristikave të tjera të ngjashme dhe që mund të ndryshojnë gjatë rrjedhës së jetës së një personi. *Gjendja ekonomike*, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore të cilët janë në pamundësi ekonomike

⁵ Raporti i Raportuesit Special për varfërinë ekstreme dhe të drejtat e njeriut, Olivier De Schutter. Ndalimi i diskriminimit për shkak të disavantazhit socio-ekonomik: një mjet thelbësor në luftën kundër varfërisë, 13 korrik 2022: <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N22/423/82/PDF/N2242382.pdf?OpenElement>

për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton në shumë fusha të jetës, në pamundësi shoqërore, arsimore, intelektuale, materiale, kulturore deri dhe ekzistenciale⁶.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminimin e znj. D.M duhet të shqyrtohet edhe bazuar në shkakun e *gjendjes shoqërore* dhe *gjendjes ekonomike*, pasi rezultoi e provuar se, znj. M ndodhet në një situatë të disavantazuar shoqërore dhe ekonomike, për shkak se është një grua beqare, kryefamiljare e vetme, e papunë dhe mjeti i vetëm i sigurimit të jetesës është ndihma ekonomike.

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë, të favorshëm dhe të pabarabartë me shkaqet e mbrojtura.

Kushtetuta e Shqipërisë në kreun për objektivat sociale, neni 59 parashikon ndër të tjera se shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që disponon, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim. Ky formulim kushtetues mund të interpretohet se Kushtetuta nuk parashikon një të drejtë të përgjithshme për strehim, në kuptimin që shteti është i detyruar në terma absolute për ta realizuar këtë të drejtë. Megjithatë në interpretim të nenit 5, 116 dhe 122 të Kushtetutës, traktatet ndërkombëtare të ratifikuara janë të pjesë e sistemit të brendshëm juridik, janë të detyrueshme për tu zbatuar dhe kanë epërsi ndaj ligjeve të vendit që nuk pajtohen me të.

E drejta ndërkombëtare e njeh të drejtën për strehim të përshtatshëm, si pjesë përbërëse thelbësore të një standarti të përshtatshëm jetese. Kjo është një e drejtë e cila nuk mund të kufizohet vetëm te pasja e në çatie ose strehe, por duhet interpretuar si e drejta që njeriu të ketë një vend ku mund të jetojë në siguri, paqe dhe dinjitet.

Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, në nenin 25 paragrafi 1, parashikon të drejtën e çdokujt për një standart të përshtatshëm jetese, përfshi të drejtën për një strehim të përshtatshëm. Neni 11 paragrafi 1, i *Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore*, deklaron se çdokush ka të drejtë për një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tij, përfshi, ushqim, veshëmbathje dhe strehim të përshtatshëm dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të jetesës. Në nenin 3, të këtij Pakti, parashikohet se, shtetet palë zotohen të sigurojnë të drejtën e barabartë të burrit dhe të gruas për t'i gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, shoqërore e kulturore të përmendura në këtë Pakt. *Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor* (neni 5 e/iii) e ndalon diskriminim racor, për gëzimin e të drejtës për strehim. *Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave* (neni 14 (2/e) dhe 15 (2)), parashikon detyrimin e shteteve palë që të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj gruas në zonat bujqësore me qëllim që të sigurojnë, mbi bazën e barazisë së burrit dhe të gruas, pjesëmarrjen e saj në zhvillimin e fshatit dhe njëherësh në avantazhet që sjell ajo. Në mënyrë të veçantë ato i

⁶ Shiko vendimin nr.104, date 7.06.2022, të Komisionerit, K.F kundër Ministrisë së Mbrojtjes: <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2022/06/Vendim-nr.-104-date-07.06.2022-K.F-kunder-Ministrise-se-Mbrojtjes-Diskriminim.pdf>

sigurojnë gruas, të drejtën për të pasur kushte jetese të përshtatshme, sidomos lidhur me strehimin, shërbimin sanitar, furnizimin me energji elektrike dhe ujë, transportin dhe komunikacionet.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), nuk parashikon të drejtën për strehim të përshtatshëm si një të drejtë të veçantë, por mbrojtja e kësaj të drejte rrjedh nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ-ja) në kuadër të garantimit të të drejtave të tjera, si e drejta për jetë private dhe familjare apo e drejta për të gëzuar lirisht pronën. Ndërkohë Protokollin 12-të të Konventës, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Në veçanti, fusha e mbrojtjes sipas nenit 1, të Protokollit të 12, të KEDNJ përfshin rastet kur personi është diskriminuar: “a) në gëzimin e çdo të drejte ligjore të njohur shprehimisht me ligj të veçantë; b) në gëzimin e çdo të drejte që rrjedh nga një detyrim i qartë i autoritetit publik sipas legjislacionit të brendshëm, sa kohë autoriteti ka detyrimin të dëshmojë një sjellje të caktuar mbi bazën e ligjit të brendshëm; c) nga autoriteti publik në ushtrimin e kompetencës diskrecionare; d) nga çdo akt apo mosveprim tjetër i autoritetit publik”.

Direktiva e Bashkimit Evropian 2000/43/Këshillit Evropian, e 29 qershorit 2000 për “Zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë ndërmjet personave pavarësisht prejardhjes racore apo etnike”. nuk e përkufizon të drejtën për strehim të përshtatshëm. Megjithatë kjo Direktivë sugjeron që interpretimi të bëhet sipas të drejtës ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në kuadrin ligjor kombëtar, e drejta për strehim të përshtatshëm, gjen rregullim në ligjin nr.22/2018 “Për strehimin social”. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative për mënyrat e planifikimit, sigurimit, administrimit dhe të shpërndarjes së programeve sociale për strehimin, me qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përbalueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim dhe në ndihmën e institucioneve shtetërore përgjegjëse. Një nga parimet e këtij ligji është parimi i mosdiskriminimit, i parashikuar nga neni 10, sipas përmbajtjes vijuese: “1. Të drejtat që burojnë nga ky ligj i garantohen pa asnjë lloj diskriminimi çdo individ, pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra, feja, etnia, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale, shtatzënia, përkatësia ose/dhe përgjegjësia prindërore, gjendja familjare ose martesore, gjendja civile, gjendja shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë dhe çdo gjendje që sjell pasoja diskriminuese.....”.

Në Kreun III, të LMD, parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Në nenin 20, pika 1 dhe pika 2, germa “d”, të LMD parashikohet: “1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të

këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi. 2. Pika 1 e këtij neni zbatohet veçanërisht për:d) sistemimin në një vend ku ofrohet strehim.....”

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëlojta për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përligjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë.” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, nr. 34, datë 20.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese)

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁷. Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu çenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁸. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme⁹. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14, nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korigjuar "pabarazitë faktike" ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹⁰.

LMD, është një ligj i cili është miratuar në bazë dhe në zbatim të nenit 18, të Kushtetutës. Në bazë të LMD, jo çdo diferencë në trajtim, konsiderohet diskriminim. Neni 6, i LMD, përcakton:

⁷ Shih: *Molla kundër Greqisë*, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; *Fábián kundër Hungarisë*, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; *Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 1985, prg.72.

⁸ Shih: *Çështja Thlimmenos kundër Greqisë* [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

⁹ Shih: *Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁰ Shih: *Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë*, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; *Çështjen Thlimmenos*, cituar më lart, prg. 44; *Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke* (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.

Barra e provës në çështjet e diskriminimit, është objekt i rregullimit të veçantë sipas LMD. Bazuar në nenin 33 pika 7/1, të LMD, sanksionohet se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.* I njëjti rregullim në lidhje me barrën e provës parashikohet edhe nga Kodi i Procedurave Administrative. Konkretisht, në nenin në nenin 82, pika 2 të Kodit të Procedurave Administrative përcaktohet se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.*

Sa më sipër, pala ankuese duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek subjekti që pretendohet se ka kryer diskriminimin, i cili duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

- Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.
- Ose duke provuar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërin nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjëse për diskriminimin.¹¹

Parimi i zhvendosjes/shpërndarjes së barrës së provës, në çështjet e diskriminimit është i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - *praesumptio iuris tantum* dhe po kështu bazohet tek logjika e përdorur për vendosjen e lidhjes mes fakteve që tregojnë *trajtim të mundshëm diskriminues* dhe *ekzistencës së këtij trajtimi në realitet*. Barra e provës zhvendoset/shpërndahet dhe pala kundër të cilës është paraqitur ankesa, për të vërtetuar se nuk ka patur diskriminim, *duhet të rrëzojë supozimin faktik se ka patur diskriminim*.

Në aspektin procedural, si fillim duhet të provojë se i vetmi shpjegim i arsyeshëm për trajtimin e diferencuar, është shkakun i mbrojtur nga diskriminimi dhe në kushtet kur arrihet ky nivel provueshmërie barra e provës për të provuar të kundërtën, që veprimet nuk përbëjnë diskriminim i bie palës tjetër. Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin

¹¹ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Sa më sipër, Komisioneri arriti në përfundimin se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, refuzimi i kërkesës së znj. D.M për të përfituar nga subvencionimi i qirasë, e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke iu mohuar e drejta për të përfituar strehim nga programet sociale të strehimit, nga ana e Bashkisë Vlorë. Në këtë mënyrë, pretendimi i Bashkisë Vlorë se, znj. D.M nuk ka përfituar nga subvencionimi i qirasë për arsye të mospërbushjes së kriterëve ligjore rezultoi i pabazuar. Si pasojë, znj. D.M është detyruar të jetojë në kushte të papërshtatshme banimi.

Komisioneri, vlerëson se, kushteve të papërshtatshme të banimit në të cilat znj. M është detyruar të jetojë, i bashkalidhet edhe rreziku i shtuar si pasojë e pandemisë së shkaktuar nga Covid 19. Në periudhën gjatë të cilës ankuesja i është drejtuar Bashkisë Vlorë, për të përfituar nga programet e strehimit social, jetesa në kushte të papërshtatshme banimi, ka përbërë një rrezik të shkuar për shëndetin, për shkak të rrezikut të infektimit me Covid 19.

Bashkia Vlorë, kundërshtoi se refuzimi i kërkesës së znj.M, për të përfituar nga subvencionimi i qirasë, të ishte bërë për shkak të përkatësisë etnike dhe gjendjes shoqërore. Sipas Bashkisë Vlorë, përgjithsisht familjet e komunitetit egjiptian, ndër vite përbëjnë rreth 30-40 % të të gjithë përfituesve të bonusit të qirasë në Bashkinë Vlorë.

Në lidhje me këtë pretendim, në bazë të të dhënave të vendosura në dispozicion nga Bashkia Vlorë në lidhje me numrin e përfituesve në përgjithësi në programet e strehimit social dhe në veçanti në programin e subvencionimit të qirasë, për pesë vitet e fundit (2017-2022), rezulton se personat nga komuniteti egjiptian janë në numër të konsiderueshëm përfitues të programeve të strehimit social pranë Bashkisë Vlorë.

Pretendimi për diskriminim ndaj znj. M, bazohet jo vetëm në shkakun e etnisë dhe faktin që ajo i përket pakicës egjiptiane në Shqipëri, por për shkak se ajo është një grua egjiptiane, duke shtuar këtu edhe vulnerabilitetin e shtuar të saj për shkak të gjendjes shoqërore, si një grua kryefamiljare e vetme dhe në kushte të vështira ekonomike, me burim të vetëm të ardhurash ndihmën ekonomike.

Në këto kushte Komisioneri vlerësoi se të dhënat e vendosura në dispozicion nga Bashkia Vlorë në lidhje me përfituesit egjiptianë të programeve të strehimit social gjatë 5 viteve të fundit, nuk ishin të përshtatme për të bërë krahasimin me gjendjen e znj. D.M, pasi nuk tregonin në lidhje me gjininë e përfituesve dhe gjendjen e tyre shoqërore. Në këtë kontekst, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Vlorë, informacion se sa prej përfituesve të programeve të strehimit social që i përkasin pakicës egjiptiane, të raportuar prej tyre, ishin në të njëjtat kushte me ato të znj.D.M, pra që ishin

gra, që jetonin të vetme. Bashkia Vlorë nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit informacionin e kërkuar.

Në lidhje me këtë kërkesë, Komisioneri evidenton faktin se, bazuar në pikën 3, të nenit 14, të ligjit nr. 9970, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, organet e qeverisjes vendore kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë.

Në bazë të informacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, përfituesit e programeve të strehimit social në pesë vitet e fundit, që i përkasin pakicës egjiptiane, sipas të dhënave të raportuara nga Bashkia Vlorë, nuk ndodhen në të njëjtat kushte me znj. D.M.

Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i znj. M, prapësoi statistikën e raportuara nga Bashkia Vlorë, duke pretenduar se, përfituesit nga pakica egjiptiane, nuk ishin në të njëjtat kushte me znj. M, pasi ata ishin shpallur përfitues si pasojë e shpronësimeve për interes publik dhe për këtë arsye janë trajtuar nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave, Nr. 58, datë 21.1.2015 “Për trajtimin e disa familjeve, që preken nga zbatimi i projektit “Lidhja e rrugës Transballkanike me superstradën Fier-Vlorë”, me programe sociale të strehimit”, të ndryshuar.

Në lidhje me këtë pretendim të palës ankuese, Komisioneri kërkoi nga Bashkia Vlorë, informacion, se mbi bazën e cilit prej kriterëve të parashikuar nga neni 13, i ligjit 22/2018, kanë përfituar përfaqësuesit e pakicës egjiptiane, të cilët kanë përfituar nga programet e strehimit social pranë kësaj bashkie. Bashkia Vlorë, nuk paraqiti asnjë prapësim dhe nuk vuri në dispozicion informacionin e kërkuar nga Komisioneri.

Nga verifikimi i bërë nga ana e Komisionerit në lidhje me listën personave që kanë përfituar nga programi social i strehimit, pagesën e qirasë, sipas VKM Nr. 58, datë 21.01.2015, të ndryshuar, në Bashkinë Vlorë, rezultoi se, nga 53 përfitues, vetëm 1 prej tyre është grua. VKM nuk ka të dhëna në lidhje me përkatësinë etnike të përfituesve, por të dhënat tregojnë se, në raport me burrat, gratë janë të nënpërfaqësuar ose pothuajse të padukshme.

Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), një organ i pavarur në kuadër të Këshillit të Evropës, i cili monitoron të drejtat e njeriut, i specializuar në çështjet e lidhura me luftën kundër racizmit, diskriminimit (për shkak të “racës”, origjinës etnike/kombëtare, ngjyrës, shtetësisë, fesë, gjuhës, orientimit seksual dhe identitetit gjinor), ksenofobisë, antisemitizmit dhe intolerancës, në raportin e tij për Shqipërinë, në ciklin e gjashtë monitorues, të publikuar në vitin 2020¹², ka konstatuar se, situata e strehimit është ende jashtëzakonisht e vështirë për shumë romë dhe egjiptianë në Shqipëri.

¹² Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (cikli i gjashtë monitorues), varianti në gjuhën shqipe: <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-translation-in-albanian-/16809e8240>

Në Raportin për vitin 2022 për Shqipërinë, Komisioni Evropian, konstaton se, të dhënat tregojnë se burrat posedojnë dhe administrojnë pronë në një masë shumë më të madhe se gratë. Të dhënat e raportuara nga Avokati i Popullit tregojnë një numër të lartë ankesash nga pjesëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian për shkelje të të drejtave pronësore.¹³

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor, në vëzhgimet përmbyllëse mbi raportet periodike të kombinuara nga i nënti te i dymbëdhjeti, për Shqipërinë, miratuar në 2018¹⁴, mbetet i shqetësuar se romët dhe egjiptianët vazhdojnë të përballen me vështirësi në fushat e punësimit, arsimit, shëndetësisë, strehimit dhe aksesit në shërbime. Në paragrafin 21, të këtij Raporti, 21. Komiteti shprehet se është i shqetësuar për mungesën e informacionit në raportin e shtetit palë mbi situatën e grave që u përkasin pakicave dhe për rastet e diskriminimit të shumfishtë ndaj të cilave ato mund të jenë subjekt. Komiteti rekomandon Shqipërinë që të marrë parasysh Rekomandimin e tij të Rërgjithshëm nr. 25 (2000) mbi dimensionet gjinore të diskriminimit racor dhe të përfshijë një perspektivë gjinore në të gjitha politikat dhe strategjitë për luftimin e diskriminimit racor me qëllim që të adresojë format e diskriminimit të shumfishtë që prekin veçanërisht gratë në komunitetin rom dhe egjiptian. (paragrafi 22 i Raportit)

Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave, në vëzhgimet përmbyllëse mbi raportin e katërt periodik të Shqipërisë, miratuar në 2016¹⁵, në paragrafët 38-39, shprehet i shqetësuar për diskriminimin e vazhdueshëm dhe mungesën e legjislacionit apo masave të duhura për mbrojtjen e grave dhe vajzave që i përkasin grupeve të pafavorizuara dhe të marginalizuara, ndër to edhe gratë rome dhe egjiptiane, veçanërisht për sa i përket aksesit të tyre, edhe në strehim. Komiteti rekomandon që Shqipëria duhet të miratojë ligje, politika dhe programe të synuara për të garantuar të drejta të barabarta për gratë që i përkasin grupeve të pafavorizuara dhe të marginalizuara, ndër të tjera, duke përmirësuar aksesin e grave rome dhe egjiptiane edhe në strehim. Në raportin e tij periodik të radhës, Komiteti kërkon informacion mbi gëzimin nga këto gra të të drejtave të tyre sipas Konventës, të ndara sipas moshës, origjinës kombëtare ose etnike dhe zonave rurale/urbane. (paragrafi 40 i Raportit)

Në raportin “Gratë dhe strehimi i përshtatshëm”, të Raportuesit Special për strehimin e përshtatshëm si komponent i së drejtës për një standard të përshtatshëm jetese dhe për të drejtën për mosdiskriminim, të vitit 2006¹⁶, evidentohet se, cikli i varfërimit - i krijuar nga diskriminimi nga ana e autoriteteve shtetërore si dhe nga aktorët privatë, në bazë të seksit, racës, origjinës etnike ose kombëtare dhe banesave të segreguara, parandalon aksesin në arsim, punësim, burimin e të ardhurave dhe sigurimin e strehimit të përshtatshëm. dhe ndikon rëndë në të drejtat e grave rome, të cilat shpesh varen ekonomikisht nga burrat e tyre. Në këtë Raport, Raportuesi Special, tërheq vëmendjen për situatën e veçantë të grave të vetme/beqare, në veçanti të nënave beqare dhe grave

¹³ Raportin për vitin 2022 për Shqipërinë, i Komisionit Evropian: <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf>.

¹⁴ <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/G19/000/09/PDF/G1900009.pdf?OpenElement>

¹⁵ https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CEDAW%2FC%2FALB%2FCO%2F4&Lang=en

¹⁶ <https://digitallibrary.un.org/record/569780>

të moshuara, të cilat përjetojnë diskriminim të shtuar për shkak të moshës ose gjendjes sociale. Raporti evidenton gjithashtu se, treguesit dhe statistikatat socio-ekonomike nga shumë vende tregojnë se gratë beqare dhe të divorcuara shpesh i përkasin grupeve ekonomisht më të pafavorizuara të shoqërisë kur krahasohen me gratë që jetojnë me një partner ose bashkëshort.

Në një raport më të vonë të publikuar nga ky Raportues Special në vitin 2021 me temë “*Diskriminimi në kontekstin e strehimit*”¹⁷, tërheq vëmendjen për faktin se diskriminimi në strehim vazhdon të jetë një nga barrierat më të përhapura dhe të vazhdueshme për përmbushjen e të drejtës për strehim të përshtatshëm. Diskriminimi në strehim është një problem global që prek shumë grupe dhe të gjithë elementët e së drejtës për strehim të përshtatshëm. Vazhdon të ekzistojë një korrelacion i fortë ndërmjet diskriminimit në strehim dhe shëndetit mjedisor dhe sigurisë fizike, aksesit në punësim, arsim dhe kujdes shëndetësor. Gratë, fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, personat nga grupet fetare, racore dhe etnike dhe pakicat, migrantët, personat e zhvendosur brenda vendit, refugjatët, personat indigjenë, personat LGBTQI+, personat që janë të pastrehë, personat që jetojnë në vendbanimeve informale ose në varfëri, janë veçanërisht të prekur nga diskriminimi në lidhje me të drejtën për strehim të përshtatshëm. Diskriminimi në të drejtën e strehimit për gratë ka mbetur i përhapur dhe i shumëanshëm. Diskriminimi gjinor me të cilën përballen gratë manifestohet shpesh në aksesin në banesat private me qira, aksesin në pronësinë e shtëpisë, trashëgiminë, sigurinë e posedimit/rezidencës, vulnerabiliteti ndaj të mbeturit e pastrehëve, dëbimet me forcë dhe kushtet e papërshtatshme të strehimit. Margjinalizimi dhe përjashtimi i individëve dhe grupeve në bazë të racës, ngjyrës, prejardhjes kombëtare ose etnike është njëkohësisht, një shtytës kryesor historik i diskriminimit në strehim dhe i ndarjes socio-hapësinore, si dhe një nga format e diskriminimi që ka mbetur edhe sot. Trashëgimia e racizmit strukturor dhe institucional në politikatat shtetërore për strehimin dhe tokën, faktorët politikë dhe institucionalë, praktikat diskriminuese nga aktorët privatë, stereotipet e përhapura racore, paragjykimet, kanë kontribuar të gjitha në pabarazitë strukturore në të drejtën për strehim të përshtatshëm, janë disa nga gjetjet e këtij raporti.¹⁸

Sipas nenit 3, pika 1 të LMD, “diskriminimi” përkufizohet si: “*çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*”. Në nenin 3, pika 3, të ligjit nr.10221.2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, parashikohet se: “3. “*Diskriminim ndërsektorial*” është ajo formë diskriminimi në të cilën disa shkaqe veprojnë dhe bashkëveprojnë me njëra-tjetrën në të njëjtën kohë, në mënyrë të tillë që ato të jenë të pandashme dhe të prodhojnë forma të veçanta të diskriminimit”.

¹⁷ <https://documents-dds-ny.un.org/doc/UNDOC/GEN/N21/289/75/PDF/N2128975.pdf?OpenElement>

¹⁸ https://www.ohchr.org/sites/default/files/2022-03/Discrimination_right2housing.pdf

Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim ndaj znj. D.M, duhet të vlerësohet në kuadër të parashikimeve të nenit 3, pika 3, të LMD, pasi pretendohet se ankuesja është diskriminuar si pasojë e ndërveprimit të më shumë se një shkaku dhe konkretisht, etnisë, gjinisë dhe gjendjes ekonomike e shoqërore, shkaqe të cilat kanë bashkëvepruar me njëra tjetrën në të njëjtën kohë për të prodhuar situatën diskriminuese të pretenduar, atë të trajtimit të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar znj. M si rezultat i refuzimit të kërkesës për të përfituar në kuadër programeve të strehimit social, nëpërmjet instrumentit të subvencionimit tëqirasë, dhe në një mënyrë të pandashme, pasi nuk identifikohen momente të veçanta të veprimit të njërit apo tjetrit shkak mbi situatën.

Konventa për Eleminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave CEDAW), në pjesën hyrëse, të nenit 2, parashikon, të: *“Shtetet palë dënojnë diskriminimin ndaj grave në të gjitha format, pranojnë të ndjekin me të gjitha mjetet e përshtashme dhe pa vonesë, një politikë të eliminimit të diskriminimit kundrejt grave...”*. Në lidhje me detyrimet që rrjedhin nga parashikimet e nenit 2, të Konventës CEDAW, në Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 28 (2010) mbi detyrimet thelbësore të shteteve palë, sipas nenit 2 të Konventës, Komiteti CEDAW, sqaron se: *“Ndërsektorialiteti është një koncept bazë për të kuptuar shtrirjen e detyrimeve të përgjithshme të shteteve palë të përfshira në nenin 2. Diskriminimi i grave në bazë të seksit dhe gjinisë është i lidhur pazgjidhshmërisht me faktorë të tjerë që prekin gratë, si raca, përkatësia etnike, feja ose besimi, shëndeti, statusi, moshë, klasa, kasta dhe orientimi seksual dhe identiteti gjinor. Diskriminimi në bazë të seksit ose gjinisë mund të prekë gratë që i përkasin grupeve të tilla në një shkallë të ndryshme ose në mënyra të ndryshme nga burrat.”*

Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit Racial, në Rekomandimin e Përgjithshëm nr.25 (2000) mbi dimensionet gjinore të diskriminimit racor, vëren se *“diskriminimi racor nuk prek gjithmonë gratë dhe burrat në mënyrë të barabartë ose në të njëjtën mënyrë. Ka rrethana në të cilat diskriminimi racor prek vetëm ose kryesisht gratë, ose prek gratë në një mënyrë të ndryshme, ose në një shkallë të ndryshme nga burrat. Një diskriminim i tillë racor shpesh do t'i shpëtojë zbulimit nëse nuk ka njohje ose njohje të qartë të përvojave të ndryshme të jetës së grave dhe burrave, si në fusha të jetës publike ashtu edhe private.”*

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e Përgjithshëm Nr. 16 (2005) *“E drejta e barabartë e burrave dhe grave për të gëzuar të gjitha të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore (neni 3 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore)”* evidenton se : *“Grave shpesh u mohohet gëzimi i barabartë i të drejtave të tyre njerëzore, veçanërisht për shkak të statusit më të vogël që u është caktuar atyre nga tradita dhe zakonet, ose si rezultat i diskriminimit të hapur ose të fshehtë. Shumë gra përjetojnë forma të ndryshme diskriminimi për shkak të ndërthurjes së seksit me faktorë të tillë si, raca, ngjyra, gjuha, feja, opinionet politike dhe të tjera, origjina kombëtare ose sociale, pasuria, lindja ose statusi tjetër, si moshë, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, gjendja martesore, statusi i refugjatit ose migrantit, duke rezultuar në disavantazh kompleks.”*

Komisioneri evidenton se, përkatësia etnike, gjinia, si dhe gjendja shoqërore dhe ekonomike e znj. D.M, janë fakte të njohura për Bashkinë Vlorë.

Komisioneri vlerëson se, bazuar në faktet dhe provat e administruara, jemi në kushtet kur mund të prezumohet (diskriminimi *prima facie*) se në pamje të parë znj. D.M, është diskriminuar për shkak të etnisë, gjinisë dhe gjendjes shoqërore dhe ekonomike, në të drejtën për një strehim të përshtatshëm. Rrjedhimisht, bazuar në standardin e provës, Bashkisë Vlorë, i kalon barra e provës për të provuar se, trajtimi i pabarabartë dhe më pak i favorshëm të cilit i është nënshtruar znj. D.M, ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Të drejtat dhe liritë duhet të garantohen jo vetëm *de jure*, por edhe *de facto*, pra të sigurohet gëzimi në mënyrë efektive nga ana e personave. Në këtë kontekst, Bashkia Vlorë në mënyrë të padrejtë, duke vlerësuar se znj. D.M ka *de jure* në pronësi një banesë, ka konkluduar se ajo nuk është e pastrehë. Bashkia Vlorë, pavarësisht se ka patur dijëni të plotë, ka injoruar faktin që znj.M nuk e gëzon në mënyrë efektive, pra *de facto* banesën e saj, jo për arsye subjektive, por për arsye objektive që nuk varen nga vullneti i saj. Sikurse rezulton, banesa e saj është zënë nga një ndërtim i paligjshëm, të cilin autoritetet kompetente nuk e kanë prishur pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të znj. M. Përpos kësaj pengese, Bashkia Vlorë është në dijëni të marrëdhënies të tensionuara midis znj. M dhe personave që kanë ndërtuar pa leje në banesën e saj. Nga ana tjetër, edhe nëse znj. M do të gëzonte në mënyrë efektive pronësinë e banesës prej 16 m2, përsëri ajo do të ishte në një situatë kur zotëron sipërfaqe banimi nën normat e strehimit, që mundësojnë një strehim të përshtatshëm. Pavarësisht të gjithave sa më sipër, Bashkia Vlorë, të mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar, ka refuzuar kërkesën e znj. M për ta trajtuar me subvencionimin e qirasë.

Bashkia Vlorë, ka qenë në dijëni të kushteve të papërshtatshme të banimit, në të cilat znj. Dallanadyshe M, jeton për shkak të refuzimit të kërkesës së saj për tu trajtuar në kuadër të programeve të strehimit social. Në kërkesat që znj. D.M i ka drejtuar Bashkisë Vlorë, kërkon që asaj t'i mundësohet çfarëdolloj mundësie tjetër, përveç subvencionimit të qirasë, në mënyrë që të ketë një strehim të përshtatshëm dhe të mos jetë e detyruar që të jetojë në kushte jo dinjitoze. E megjithatë Bashkia Vlorë nuk ka ndërmarrë asnjë masë për të vlerësuar gjendjen e znj. M me qëllim sigurimin e një stehimi të përshtatshëm për të.

Sipas nenit 11/2, të ligjit nr.22/2018, njësitë e vetëqeverisjes vendore kujdesen që familjet dhe individët, të cilët nuk kualifikohen si përfitues në njërin program, të kenë mundësi për të kaluar dhe përfituar në një program tjetër strehimi social, kur plotësojnë kushtet ligjore. Bashkia Vlorë nuk provoi se në cilësinë e njësisë së vetëqeverisjes vendore të ketë bërë një vlerësim në lidhje me mundësinë e znj. D.M për të përfituar nga ndonjë program tjetër i stregimit social.

Komisioneri vlerëson se, Bashkia Vlorë ka treguar një qëndrim pasiv të pajustificuar në lidhje me trajtimin e znj. D.M, pavarësisht se ka qenë në dijëni të vulnerabiliteteve të shtuara të saj, si grua egiptiane, beqare dhe kryefamiljare e vetme ku burimi i vetëm për të siguruar jetesën është

ndihma ekonomike. Në këtë kontekst Komisioneri gjykon se Bashkia Vlorë nuk e ka trajtuar në mënyrë efektive rastin e znj. D.M në raport me faktin se ajo i përken një grupi të disavantazhuar në disa drejtime, çka sjell si pasojë një disavantash kompleks.

Komisioneri thekson gjithashtu faktin se, Bashkia Vlorë nuk arriti të tregojë se praktika dhe qasja e saj në zbatimin e programeve të strehimit social, mundëson gëzimin në mënyrë efektive të të drejtës për strehim për personat që janë në të njëjtat kushte me znj. D.M.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara në lidhje me rastin konkret të znj. D.M, Komisioneri vlerëson se Bashkia Vlorë dështoi që të jepte një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, se trajtimi i padrejtë, i pafavorshëm dhe i pabarabartë të cilit i është nënshtruar znj. D.M, nuk ka ardhur si pasojë e ndërveprimit të etnisë, gjinisë dhe gjendjes shoqërore dhe ekonomike.

Komisioneri arrin në përfundimin se, znj. D.M është diskriminuar në të drejtën për strehim të përshtatshëm, në formën e diskriminimit ndërsektorial, për shkak të etnisë, gjinisë, dhe gjendjes shoqërore e ekonomike, si rezultat i refuzimit të kërkesës për të përfituar në kuadër të programeve të strehimit social, nëpërmjet instrumentit të subvencionimit të qirasë, nga ana e Bashkisë Vlorë. Për rrjedhojë Bashkia Vlorë, ka shkelur ndalimin e diskriminimit, të parashikuar nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre”, ndërsa në nenin 33, pika 12, përcaktohet se : “Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës”

Ligji nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ky ligj, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese është marrja e masave nga ana e Bashkisë Vlorë për të siguruar strehim të përshtatshëm për znj. D.M, në kuadër të programeve të strehimit, që i përshtaten situatës në të cilën ajo ndodhet.

PËR KËTO ARSYE :

Bazuar në nenin 33 pikat 10, 11, 12 e 13, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të znj.D.M, në të drejtën për strehim të përshtatshëm, në formën e “*diskriminimit ndërsektorial*”, për shkak të etnisë, gjinisë, si dhe gjendjes shoqërore dhe ekonomike, nga ana e Bashkisë Vlorë.
2. Në referim të pikës 1, Bashkia Vlorë, të marrë masa për të siguruar strehim të përshtatshëm për znj. D.M, në kuadër të programeve të strehimit, në përputhje me rrethanat dhe situatën në të cilën ankuesja ndodhet.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Vlorë, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Shkaku: Etnia, gjinia, gjendja shoqërore dhe ekonomike
Fusha: Të mira e shërbime/Strehim
Lloji i vendimit: Diskriminim ndërsektorial